



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I PSIKOLOGUT
KËSHILLI KOMBËTAR



Bhv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, kati II, Ap.9, Tiranë, email: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035544 51 1804

Tiranë më 03.02.2021

VENDIM

Nr. 1, Datë 03.02.2021

Bazuar në nenin 19.2.3.), të Rregullores së Gjykimit Disiplinor e Profesional në datë 03.02.2021, u thirr Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë nga Presidentja e Urdhrit të Psikologut, për shqyrtimin e ankesës së psikologes Znj.Jesmina Hasani me palë ankuese Z.Eris Kola mbi Vendimin Nr 9, Datë 18.12.2020 të Komisionit Etik dhe Gjykimit Disiplinor e Profesional.

Pasi u njohën me ankesën dhe dosjen e çështjes në fjalë, Këshilli Kombëtar

VENDOSI:

1. Të ndryshojë vendimin Nr 9, Datë 18.12.2020 të Komisionit Etik dhe Gjykimit Disiplinor e Profesional, me 8(tetë) vota pro dhe asnjë kundër.
2. Të lihet në fuqi mendimi i pakicës së dhënë nga ky komision: **Vërejtje me paralajmërim për heqjen e të drejtës së ushtrimit të profesionit**
3. Bashkëngjitur gjeni mendimin e pakicës.


PRESIDENTE E URDHRIT

Valbona Treska



SEKRETARE

Armira Baboçi



Mendim Pakice

Unë i nënshkruari Igli Çutra, anëtar i Komisionit Etik dhe Gjykit Disiplinor Profesional, pranë Urdhrit të Psikologut, kam votuar ndryshe nga vendimi i shumicës së anëtarëve të Komisionit, të cilët vendosën pranimin e ankesës së Z.Eris Kola, në gjykimin disiplinor ndaj psikologes Znj.Jesmina Hasani, ku u mor vendimi: **“Përjashtimin e psikologes nga Urdhri i Psikologut për një periudhë 18 mujore”.**

Më poshtë po Ju rendis arsyet dhe argumentat e vendimit tim:

Pasi shqyrtova me kujdes të gjitha dokumentat dhe provat e paraqitura nga pala ankuese Z.Eris Kola, qëndrimin mbrojtës të psikologes Znj.Jesmina Hasani, lidhur me çështjen disiplinore, të iniciuar nga Z.Eris Kola në sajë të ankesës mbërritur në zyrën e Urdhrit të Psikologut datë 21.10.2020, protokolluar me nr.427 Prot, kundrejt psikologes Znj.Jesmina Hasani, si dhe pas zhvillimit të seancës dëgjimore datë 18.12.2020, ku dëgjuam me shumë kujdes të dyja palët, gjykoj si më poshtë:

Në fillim dëshiroj të konstatoj faktin se në dosjen e gjykimit disiplinor në çështjen mes psikologes Znj.Jesmina Hasani dhe palës ankuese Z.Eris Kola, mungonte Raporti i Vlerësimit Psiko-Social, i hartuar nga psikologia. Gjykoj se duke qenë se është një element shumë i rëndësishëm dhe një provë e domosdoshme për nisjen e shqyrtimit të këtij rasti, do duhet të ishte kërkuar nga Relatori i Çështjes më parë , se sa psikologia të na e vinte në dispozicion vetë gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

1. Lidhur me pretendimin e palës ankuese Z.Eris Kola se psikologia Znj. Hasani ka shkelur Standardin **10.01 Marrja e miratimit të informuar në terapi.** (b) “*Për personat që janë ligjërisht të paftë për të dhënë miratim, psikologët në çdo rast mbajnë parasysh interesin më të lartë të individit, dhe nëse është e mundur, sigurojnë miratimin e informuar nga personi i autorizuar ligjërisht*”, sqaroj se:

Pala ankuese pretendon se sipas vendimit të Gjykatës nr. 102787, datë- 27/07/2020, për masën e përkohshme, personi që ka kujdestarinë për fëmijët është i ati Z. Eris Kola. Ai nuk është informuar apo ka dhënë miratimin e informuar, të firmosur, ndaj psikologia Znj.Hasani duhej më parë të ishte informuar lidhur me këtë fakt dhe të kërkonte edhe miratimin e babait të vajzës, si kujdestari i saj ligjor, e më pas të kryente vlerësimin. Së pari dëshiroj të sqaroj se kemi të bëjmë me një vendim të përkohshëm dhe jo përfundimtar të Gjykatës sa i përket kujdestarise së të miturve, por megjithatë përgjegjësia prindërore u takon të dy prindërvë në çdo rast. Psikologia Znj.Hasani ka vënë në dijeni dhe ka marrë miratimin nga e ëma e të miturës

Znj.Gabriela Lazri, ndaj mbështetur nga sa më sipër gjykoj se nuk jemi në kushtet e shkeljes së Standardit 10.01 Marrja e miratimit të informuar. Megjithatë rekomandojmë psikologen Znj.Hasani se duhet të tregohet më e kujdeshshme në të ardhmen pasi, ne raste të tilla ku çështja paraqet konflikt në marrëdhënien në çift, do të ishte më e udhës të merrej miratimi i të dy prindërve, e më pas të kryhej vlerësimi psikologjik.

- 2. Konstatimin e shkeljes nga psikologia Znj.Hasani të Standardit 2.01 Kufijtë e Kompetencës** (b) *Psikologët e ushtrojnë profesionin e tyre në ambiente të përshtatshme për ushtrimin e profesionit. Përveç psikologëve që ushtrojnë profesionin në organizata, institucionë publike apo private, psikologu duhet të marrë masa të përshtatshme, që vendi ku ushtron profesionin të sigurojë privatësinë, ruajtjen e konfidencialitetit dhe të jetë në përputhje me llojin e profitit të shërbimit të ofruar. Përveç rasteve të emergjencave apo përveçse kur është në përputhje me qëllimin për të cilin realizohet, psikologu nuk e ushtron aktivitetin e tij në mqedise publike apo jashtë vendit ku ushtron zyrtarisht aktivitetin.*

Sikundër u pohua edhe nga vetë nga psikologia Znj.Hasani,gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, intervista me fëmijën e mitur dhe nënën e saj është kryer në një park lodrash dhe jo në ambientin e zyrës së punës së psikologes. Duke qenë se nuk jemi përpara rasteve të emergjencës apo në përputhje me qëllimin për të cilin realizohet,gjykoj se psikologia ka shkelur këtë standard të Kodit të Etikës.

Lidhur me pretendimet e tjera të palës ankuese Z.Eris Kola, në ankesën e paraqitur drejtuar Komisionit Etik, gjykoj se nuk janë të bazuara e të mbështetura në fakte dhe prova, ndaj nuk duhet të merren në konsideratë nga Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional.

- 3. Konkretisht lidhur me pretendimet e palës ankuese se Znj.Jesmina Hasani, duke qenë se është kolege me Znj.Gabriela, pasi punojnë në një institucion, ka shkelur parimet e Besnikërisë dhe Përgjegjësisë, si dhe parimin e Drejtësisë, si dhe Standardin 2.06 Problemët personale dhe konfliketet** ku thuhet se: (a) *Psikologët e shmangin fillimin e një aktiviteti profesional kur e dinë ose duhet të dinë, se ekziston një mundësi objektivisht e konsiderueshme, që problemet e tyre personale do t'i pengojnë në realizimin e tij në mënyrën e duhur.*

- (a) *Kur psikologët, gjatë kryerjes së një detyre profesionale, bëhen të vetëdijshëm për probleme personale, që mund të ndikojnë në realizimin e duhur të saj, duhet të marrin masa të përshtatshme, si konsultim ose asistencë profesionale, për të përcaktuar kohën, se kur duhet të kufizojnë, pezullojnë ose ndërpresin detyrën profesionale të nisur. (Shih Standardin 10.10 Ndërprerja e terapisë), sqaroj se:*

Znj.Gabriela Lazri (e ëma e të miturës) dhe Znj.Jesmina Hasani pavarësisht se ushtrojnë profesionin në të njëjtin institucion, janë vetëm kolege dhe nuk provohet se kanë asnjë lloj varësie apo interesë ndërmjet tyre. Znj.Hasani punon në 7 shkolla të ndryshe, si rrjedhojë ka njojje me shumë kolegë gjatë punës së saj, por në këtë rast njojja e tyre si kolege nuk përbën konflik interesi, konflikt i cili përcaktohet qartësisht në **Standardin 3.06 Konflikti i interesit** ku thuhet se: **Psikologët refuzojnë marrjen e një detyrimi profesional, kur interesat personale, shkencore, profesionale, ligjore, financiare, familjare ose marrëdhënie të tjera, mund të ndikojnë në objektivitetin apo efikasitetin e kryerjes së këtij detyrimi.** Gjithashtu nuk provohet që mes tyre të ketë probleme personale apo konflikte, që mund të ndikojnë në realizimin e detyrës profesionale siç duhet, nga ana e psikologes.

4. Lidhur me pretendimin tjetët të palës ankuese Z.Eris Kola, se psikologia Znj.Jesmina Hasani ka shkelur Standardin 2.01 a) Kufijtë e Kompetencës *a) Psikologët ofrojnë shërbime, japid mësim dhe kryejnë kërkime shkencore në popullata vetëm në ato fusha që janë brenda kufijve të kompetencave të tyre, bazuar në arsimimin, trajnimet, eksperientat e supervizuara, konsultimet, studimet ose përvojat e tyre profesionale. Psikologët nuk duhet të ushtrojnë kompetenca jashtë fushës së tyre, të cilat lidhen me disiplina të tjera si p.sh.: sociologji, punë sociale, mjekësi, etj, kërkojmë të sqarojmë se:*

Psikologia Znj.Jesmina Hasani është anëtare e Urdhrit të Psikologut me nr.1377 regjistri si dhe është e licencuar nga Komisioni i Licencimit pranë Urdhrit të Psikologut me nr.547. Ajo është e diplomuar në profilin Orinetim Profesional. Sqarojmë se Raporti i Vlerësimit psiko-social, datë 26.09.2020, i hartuar nga psikologia Znj.Jesmina Hasani, është një raport vlerësimi psikologjik,i kryer nga psikologia privatish, pas kërkesës dhe miratimit që ka dhënë nëna e të miturës dhe nuk është një raport psikologjik i kërkuar nga gjykata, apo insitacione të tjera të drejtësisë. Theksojmë se gjykata me të drejtë nuk e ka pranuar si provë, raportin psikologjik të psikologës së dhënë në seancë gjyqësore nga Znj.Gabriela Lazri, pasi ai raport nuk është Raport Vlerësimi i kërkuar nga ky insitucion, pasi psikologia Znj.Hasani nuk është thirrur nga gjykata as në cilësinë e Ekspertes Psikologe dhe as si Dëshmitare, në atë proces gjyqësor.

Nisur nga sa më sipër Raport-Vlerësimi psiko-social i hartuar nga ajo, është një raport vlerësimi të cilin psikologia Znj.Hasani ka të drejtë ta hartojë, duke qenë se ajo është e licencuar, si dhe plotëson kriteret për të ushtruar profesionin si psikologe. Urdhri i Psikologut madje në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, kur kanë zhvilluar trajnimin për psikologët në fushën e Drejtësisë ka pranuar të trajnohen në të psikologë të profileve të ndryshme, ndaj edhe psikologia Znj.Hasani megjithëse është e licencuar si psikologe në Orientim Profesional, nuk mund të ndalohet të hartojë Raporte Vlerësimi Psikologjik, kur këto raporte janë në funksion të punës së saj dhe kur nuk tejkalojen kompetencat e diktuarë nga ligji apo nga Kodi i Etikës dhe Deontologjisë.

- 5.** Lidhur me pretendimin e fundit të palës ankuese Z.Eris Kola, se është **shkelur Standardi 9.01 a) Bazat e Vlerësimit** ku thuhet se: (a) *Psikologët i bazojnë opinionet e paraqitura në rekomandimet, raportet, diagnostikimet ose deklaratat vlerësuese, duke përfshire edhe vlerësimet ligjore, mbi informacione dhe teknika të mjaftueshme për të mbështetur gjetjet e tyre. Psikologët përdorin si baza të vlerësimit vetëm instrumente të standardizuara, përveç rasteve kur vlerësimi kërkohet pikërisht për efekt të standardizimit. Në çdo rast, psikologët duhet të bëjnë të qartë kufizimet e përdorimit të opinioneve, për shkak të limiteve të standardizimit.(Shih Standardin 2.04 Bazat për gjykimet shkencore dhe profesionale), sqarojmë se kur në kushtet kur ende nuk kemi protokolle të punës që udhëzojnë psikologun në kryerjen e funksionit të tij, nuk mund të diktohen metodat dhe metodologjia e punës, që zgjedh të përdor secili psikolog individualisht, në realizimin e punës së tij.*

Në përfundim: Nisur nga sa më sipër gjykoj se gjatë ushtrimit të funksionit të saj, psikologja Znj.Jesmina Hasani, ka *shkelur Standardin 2.01 a) Kufinjtë e Kompetencës, si dhe rekomandohet të jetë me e kujdeshshme sa i përket marrjes së Miratimit të Informuar nga ana e prindërve Standardi 10.01 Marrja e Miratimit të Informuar ne terapi, ndaj për këto arsyet bazuar në nenin 20, pika 1 b) të Ligjit Nr. 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë", si dhe në nenin 12, pika 1b) të Rregullores së Gjykimit Disiplinor Profesional, t'i jepet psikologes Znj.Jesmina Hasani masa disiplinore:*

"Vërejtje me paralajmërim për heqjen e të drejtës së ushtrimit të profesionit"

Igli Çutra (anëtar)

